**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJGJEVE PËR VITIN 2025**

Periudha ( Maj 2025 )

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | 15.05.2025 | 1.Lutem, të më informoni specifikisht për secilen sipërfaqe të mëposhtme se cili është institucioni përgjegjës në pronësinë e të cilit ndodhen këto prona specifikisht, të më informoni në lidhje me mundësine e marrjes me qera të këtyre pasurive shtet, bazën ligjore, procedurat, kriteret dhe cdo informacion të mundshëm të specifikuar, në funksion të kërkesës time.<br>Pasuria **nr.66/1/2** e llojit 'Arë', Zona Kadestrale 1367 fshati Cepë në emër të SHTET.<br>Pasuria **nr.66/3** e llojit 'Arë', Zona Kadestrale 1367 fshati Cepë në emër të SHTET.<br>Pasuria **nr. 64** e llojit "Perrua", Zona Kadestrale 1367 fshati Cepë në emër të SHTET.<br>Pasuria **nr. 347** e llojit "Kullote", Zona Kadestrale 1897 fshati Guri I bardhe në emër të SHTET. | 22.05.2025 | 1.Pasuria 66/1/2 e llojit "Arë", mbështetur në dokumentat që ne disponojmë sipas Printimit 3, kjo pasuri nuk na rezulton e hedhur. Dokumentat që bashkia Belsh disponon janë të azhornimit të vitit 1996.<br>2.Pasuria 66/3 e regjistruar pronë shteti e llojit arë, mbështetur në Printimin 3, referuar VKM Nr. 45, datë 29.1.2014 "Për kalimin në andministrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të Ish-Ndërmarrjeve Bujqësore dhe Ish-Institucioneve Kërkimore-Shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave", është kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë ti japë me qira pronat e llojit "Arë" të fshatrave ISH-Ndërmarrje Bujqësore.<br>3.Përsa i përket pasurisë Nr. 64 e llojit "Përrua", bashkia Belsh nuk disponon Titull Pronësie.<br>4.Pasuria 347 e llojit "Kullotë", referuar VKM Nr. 684, datë 02.09.2020 | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike” kjo pasuri nuk ndodhet tek lista e inventarit sipas VKM Nr. 684, datë 02.09.2020. Për këtë arsye pasuria Nr. 64 e llojit “Përrua”, nuk mund të jepet me qira nga bashkia Belsh pasi nuk disponon Titull Pronësie. | | |
| 18 | 26.05.2025 | Ju lutem më informoni nëse ekziston mundësia e:<br>-Marrjes në përdorim të një sipërfaqeje toke publike apo të pashfrytëzuar, përmes marrëveshjes me bashkinë ose me banorë të zones?<br>-Mbështetjes së bashkisë për aplikim në kuadër të “Mountain Package” për zhvillim rural?<br>-Këshillimit mbi procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim? | 02.06.2025 | Lidhur me kërkesën tuaj, për interesimin e treguar ndaj territorit të Bashkisë Belsh dhe për iniciativëntuaj në përputhje me vlerat natyrore dhe kulturore të zones tone, ju bëjmë me dije se aktualisht:<br>-Zbatimi i “Mountain Package” për zhvillim rural nuk ka filluar ende për shkak të mungesës së udhëzimeve dhe proçedurave të qarta ligjore për zbatimin e tij. Megjithatë, ekziston mundësia që:<br>-Të realizoni një marrëveshje qiraje ose bashkëpunimi me banorë të zones që disponojnë sipërfaqe toke të përshtatshme për projektin tuaj. | E plotë | Pa pagesë |